

## MENDIM PAKICE

Unë, komisioner Lulzim Hamitaj, si anëtar i trupit gjykues nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku, me funksion ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkak se vlerësoj që subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm edhe në rivlerësimin e pasurisë, për sa kohë problematikat e konstatuara nuk mund të çmoheshin penalizuese – si në këndvështrimin sasior, ashtu edhe në raport me periudhën para detyrës. Për më tepër, çmohet se konstatimet e Komisionit lidhur me pasaktësitë në deklarime apo pamjaftueshmërinë financiare (prej vetëm 600.000 lekësh) janë pasojë e një konfuzioni të krijuar në sferën e marrëdhënieve të posaçme (me nënën dhe vëllezërit, përpara fillimit të detyrës) e, për rrjedhojë, janë të pamjaftueshme për të penalizuar subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, në lidhje me kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale (si dhe me pikat e tjera të ndërthurura me rivlerësimin e kriterit të pasurisë, që nuk do të analizohen në vijim), në vlerësimin tim nuk integrojnë kristalizimin e një niveli të tillë si cenimi i besimit të publikut në Sistemin e Drejtësisë, që të mjaftojë (as në vlerësimin tërësor të çështjes në fjalë) për të aplikuar nenin 61, pika 5, masën e shkarkimit nga detyra. Kjo, jo vetëm për peshën specifike të gjetjeve, të cilat nuk rezultojnë domethënëse apo përcaktuese, por edhe nisur nga rrethana që përgjatë gjithë periudhës në analizë ky subjekt nuk ka qenë pjesë e Sistemit të Drejtësisë, pasi e ka nisur detyrën e ndihmëses ligjore në datën 7.6.2016, pra vetëm rreth gjashtë muaj përpara së të dorëzonte deklaratën *Vetting*.

Kësisoj, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit duhej të ishte konfirmuar në detyrë, për sa kohë ndaj mendim ndryshe lidhur me konkluzionet, vlerësimet finale dhe vendimmarrjen përfundimtare, në raport me disa pika të vendimit, të cilat do të citohen shkurtimisht në vijim:

**1. Lidhur me pikën 52.1 të vendimit të Komisionit**, ku veç të tjerash përshkruhet: “[...] 52.1. Në pikën 3 të tij, neni 61 i ligjit nr. 84/2016 parashikon një nga rastet e marrjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjekteve, që është deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. [...] Në interpretim strikt të kësaj dispozite ligjore, në përfundim të procesit, gjatë vlerësimit të së vetmes deklaratë të subjektit, asaj *Vetting*, u konstatua se subjekti: a. [...].

b. [...] Në deklaratimet e saj lidhur me kreditë pranë Fondit Besa, subjekti pohon se shlyerja e kredive në një rast është bërë me të ardhurat e përfutuara nga kredia e marrë, veprim i pajustificuar financiarisht, por edhe objektivisht referuar fakteve dhe provave arsyetuar më sipër në këtë vendim dhe në rastet e tjera deklararon se është bërë me të ardhura të vëllezërve, për të cilat nuk paraqiti asnjë dokument provues.

Megjithatë, sa i takon pamundësisë financiare për të krijuar likuiditetin cash prej 600.000 lekësh, si rrethanë më vete ky fakt nuk përbën shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, por është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në raport me qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në posedim/përdorim, që sipas pikës 5 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës përbën shkak që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra”.

Lidhur me konkluzionet e mësipërme, pakica vlerëson se pasaktësitë në deklaratimet e subjektit (në të vetmin deklaram që ka kryer për efekt të vlerësimit kalimtar) nuk përmbushin elementet për t’u klasifikuar si përpjekje për të fshehur ndonjë pasuri, si dhe veprimet financiare apo

marrëdhëniet e tjera të veçanta mes familjarëve – ndonëse është krijuar një konfuzion ndërfaqiljar – parë në dinamikën dhe kontekstin e periudhës që kanë ndodhur (përpara detyrës) nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkim. Kjo pasi, ndonëse është e vërtetë që subjekti ka qenë protagoniste e shumë lëvizjeve monetare, sikurse “administruese” e përkohshme e marrëdhënieve të qiradhënies, kredimarrje (me prokurë), shlyerje kredie etj., me persona të tretë apo institucione financiare, duke krijuar konfuzion të qarkullimeve, shkaqeve, pritshmërive të të drejtave, por duke mbajtur në vëmendje që: (i) këto fakte kanë ndodhur brenda familjes, me dakordësi dhe ndërveprim të titullarëve të të drejtave reale/financiare (të nënës dhe vëllezërve); (ii) përfshirja e subjektit është nevojitur dhe influencuar nga rrethanat konkrete të familjarëve (si nëna e moshuar dhe me probleme shëndetësore, si dhe vëllai për shumë kohë ka banuar jashtë territorit shqiptar); (iii) në periudhën e dinamikës konfuzive të fakteve subjekti nuk kishte nisur detyrën e ndihmësës ligjore, nuk ishte subjekt deklarues, e kësaj nuk mbartte detyrimin apo nevojën për kujdesje të shtuar për të mos u përfshirë në rrethana të paqarta lëvizjesh monetare (ndonëse brenda familjes) – krijohet bindja se subjekti nuk mund të shkarkohet për shkak të kësaj situatë.

Lidhur me deklarin e apartamentit të nënës së subjektit, vlerësoj se nuk mund të prezumohet se subjekti ka përfituar të drejta reale, kur kjo rrethanë nuk është e provuar dhe as nuk mund të provohet nëpërmjet faktit që subjekti ka banuar në atë apartament, pasi kjo lidhje e subjektit me pasurinë (për sa i përket përdorimit) është më se e natyrshme, për sa kohë banonte aty në cilësinë e vajzës së pronares, pra në banesën familjare.

Gjithashtu, duhet të përmendet fakti se subjekti e ka deklaruar rregullisht si adresë vendbanimi këtë pasuri dhe, në këto kushte, duket kontradiktore dhe e pabazuar hipoteza (penalizuese) e mosdeklarimit të të drejtave reale (të prezumuara), apo aq më pak të përdorimit të sendit, kur subjekti nuk e ka mohuar, por e ka deklaruar këtë pasuri si vendbanim.

Për sa i përket pamundësive financiare – sikurse është shprehur edhe shumica – pamjaftueshmëria prej 600.000 lekësh lidhur me gjendjen *cash* (vetëm), për të cilën subjekti i është kaluar barra e provës, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk përbën shkak penalizues për subjektin.

## **2. Lidhur me pikën 52.2 si më poshtë:**

*“[...] 52.2. Nga vlerësimi tërësor i kriterëve të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, [...] në përfundim të procesit u vlerësua se me veprimet dhe mosveprimet e saj subjekti ka dështuar të provojë se është një figurë e besuar për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, që e vë atë në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni i referohet të gjitha konstatimeve të analizuara hollësisht dhe të nënvizuara më sipër në këtë vendim, që në mënyrë të përmbledhur i referohen fakteve dhe rrethanave të poshtëshënuara. a.[...], b.[...], c.[...].*

*d. Në një vlerësim tërësor të të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit, u konstatua se: (i) subjekti nuk është koherente me deklarin e mëparshme të saj dhe as me fakte të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, duke i ndryshuar ato vazhdimisht; (ii) në mënyrë të përsëritur i është shmangur dhënies së përgjigjeve në lidhje me disa nga konstatimet e Komisionit; (iii) në çdo rast i është shmangur kryerjes së veprimeve nëpërmjet llogarive bankare në të cilat gjen pasqyrim vetëm disbursimi i shumave të përfituara nga kreditë dhe, për më tepër, të gjitha shlyerjet e kredive janë bërë në cash prej saj”.*

3. Gjithashtu, vlerësoj se faktet e përmendura në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 52.2 si më lart nuk mund të përbëjnë shkak për cenimin e besimit tek publiku e kësisoj, në rastin konkret, nuk mund të aplikohet neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Kjo pasi, përpos interpretimit të sforcuar të fakteve dhe arsytimit hipotetik, në pikat e lartpërmendura, lidhur me të cilat unë nuk bie dakord, edhe nëse do të arsyetohej mbi ato konstatime, parë në kontekstin e marrëdhënieve të posaçme familjare (e jo me publikun) dhe në periudhën që ato kanë ndodhur (para detyrës), sipas meje nuk arrihet të kristalizohen një apo më shumë pasoja (etike) të veprimeve të subjektit me efekte negative në opinionin publik, që të mund të cenonin besimin e publikut. Në këto kushte, parë në tërësinë e saj, faktet, periudhën e tyre, efektet, qëndrimin e subjektit, llojin e detyrës si këshilltare ligjore e kryerjen e saj për vetëm rreth 6 muaj përpara deklaratës *Vetting*, çmoj se nuk gjendemi përballë një rasti të penalizueshëm për cenimin e besimit të publikut.

4. Nisur nga sa më sipër është arsyetuar nga pakica, rrjedhimisht nuk jam dakord as me vlerësimin përfundimtar të shprehur nga shumica në pikën 52.3 të vendimit *de quo*, kryesisht për shkak të vlerësimit dhe argumentimit ndryshe që unë i kam bërë më sipër disa fakteve e rrethanave të qenësishme, por edhe për faktin që rastet e jurisprudencës së Kolegjit të përmendura në këtë vendim nga shumica, nga ana ime konsiderohen se nuk janë mjaftueshëm të ngjashme me rastin konkret – madje mjaft të ndryshme në disa specifika të veçanta (që kanë rezultuar përcaktuese për penalizimin) dhe në dinamikat e çështjeve përkatëse, të cilave këto vendime u referohen.

5. Për rrjedhojë, në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe në metodologjinë e rivlerësimit për këtë kriter, të përshkruar më sipër, unë, si anëtar në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë dhe nuk ka bërë deklaratime të pamjaftueshme në lidhje me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ndërkohë që lidhur me të dyja kriteret e tjera nuk janë evidentuar problematika as nga shumica. Kësisoj, gjendur në këto kushte, çmoj se masa e shkarikimit për këtë subjekt nuk është proporcionale dhe as në harmoni me kuadrin faktiko-ligjor apo jurisprudencën përkatëse.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, nuk është i drejtë, pasi çmoj se i ka përmbushur të tria kushtet e parashikuara në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Për arsytet e sipërcituara, sipas parashikimeve të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në provat që disponon Komisioni, në përgjigjet e subjektit dhe në deklaratimet e bëra prej saj në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Për rrjedhojë, krijohet bindja se shumica nuk duhet të kishte disponuar shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, por konfirmimin në detyrë.

**Lulzim HAMITAJ**  
**Anëtar në pakicë/kundër**